



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**REXHINA HARASANI**

Rexhina Harasani është emëruar Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Arsimore pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore në korrik 2025. Ajo sjell në këtë pozicion një përvojë të gjerë në administratën publike, menaxhimin institucional, shërbimet sociale, vlerësimin arsimor dhe planifikimin e ndërhyrjeve edukative për fëmijët.

Përpara këtij emërimi, znj. Harasani ka shërbyer si Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Provimeve pranë Drejtorisë së Vlerësimit në QSHA (2024–2025), ku ka kontribuar në menaxhimin e proceseve kombëtare të provimeve, menaxhimin e databazave, koordinimin me institucionet arsimore dhe garantimin e standardeve të vlerësimit.

Nga viti 2022 deri në vitin 2024, ajo ka mbajtur pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit Social në Shtëpinë e Foshnjes Tiranë, pranë Shërbimit Social Shtetëror. Në këtë rol, ka udhëhequr proceset e kujdesit dhe ndërhyrjeve psiko–sociale, vlerësimin zhvillimor dhe planifikimin e planeve edukative–mësimore individuale për fëmijët në kujdes institucional. Ajo ka koordinuar punën ndërdisiplinore dhe ka garantuar zbatimin e praktikave të kujdesit dhe edukimit të hershëm në përputhje me standardet bashkëkohore.

Ajo ka eksperiencë edhe në sektorin bankar, ku ka punuar në shërbimin e klientit gjatë vitit 2022, duke ndërtuar aftësi të forta në komunikim, menaxhim situatash dhe raportim.

Karriera e saj profesionale ka filluar në vitin 2019 në Njësinë Bashkiake nr. 9, Tiranë, ku ka shërbyer si specialiste në Sektorin e Vlerësimit të Nevojave dhe Verifikimit të Rastit. Aty ka punuar me familjet dhe fëmijët në nevojë, ka realizuar vlerësime, dhe ka ndjekur raste të referuara pranë shkollave, duke evidentuar, planifikuar dhe monitoruar nevojat edukative dhe psiko–sociale të fëmijëve.

Znj. Harasani ka një formim të kombinuar shkencor dhe ndërdisiplinor. Ajo ka përfunduar studimet Bachelor në Psikologji dhe më pas Masterin Shkencor në Psikologji Klinike. Aktualisht është në përfundim të Masterit të saj të dytë, Master Shkencor në Sistemet e Informacionit në Biznes me bazë informatikë, duke bashkuar ekspertizën psiko–sociale me aftësitë moderne në dizajnin dhe administrimin e sistemeve të informacionit, analizën e të dhënave dhe menaxhimin institucional.

Ajo zotëron njohuri shumë të mira të gjuhës angleze. Ka ndjekur një sërë trajnimesh të specializuara në menaxhimin e burimeve njerëzore, lidërsip, komunikim organizativ dhe zhvillim profesional, duke forcuar aftësitë e saj drejtuese dhe menaxhimin efektiv të ekipeve, projekteve dhe proceseve institucionale.

Falë këtij profili të pasur, që ndërthur psikologjinë, shërbimet sociale, administrimin publik, teknologjinë e informacionit dhe zhvillimin e kapaciteteve drejtuese, znj. Harasani sjell një qasje të integruar dhe bashkëkohore në drejtimin e proceseve arsimore, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve, efikasitetit institucionale dhe mbështetjes profesionale për strukturat arsimore në nivel vendor dhe kombëtar.